



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

Nr. 5242 prot.,

Tiranë më 24.10.2024

NJOFTIM

**SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE, SPECIALIST ARKIVE,
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin nr.643, datë 23.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisive të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurimit të hapur" si dhe vendimit nr .4, datë 02/03/2022 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Lartë, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- I. **1 (një) pozicion – “specialist arkive”- Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria ekzekutive (IV I)**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin si më sipër është:

Specialist Arkive:

- mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, i cili përfshin dosje, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore, si dhe akte që lidhen me veprimtarinë administrative të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat shtetërore; merr masa që ambienti i arkivit të jetë i siguar nga thyerjet e të ketë mjete mbrojtëse kundër zjarrit dhe të plotësohen kushtet teknike e teknologjike të domosdoshme për ruajtjen e arkivit ;
- lëshon kopje të vendimeve të fondit të arkivit të Gjykatës së Lartë, të cilat njësohen nga përgjegjësi i sektorit të administrimit gjyqësor;
- merr masa për ruajtjen e dokumenteve të gjykates, të cilat përbëhen nga fashikujt gjyqësore penalë dhe civile, vendimet e të cilëve kanë marrë formë të prerë, merr masa për mbajtjen dhe përpunimin mbi baza shkencore të dokumentacionit administrativ;
- vendos në dispozicion të gjyqtarëve, dosjet për llogari të gjykimit; Kujdeset të ruajë fashikujt gjyqësorë të çështjeve me objekt rishikim të vendimeve civile dhe penale
- shumëfishon dosjet dhe vendimet të cilat administrohen në kodekse;
- në përputhje me ligjin, merr masat teknike për asgjësimin e dokumentacionit që u ka kaluar afati i ruajtjes së tyre;
- bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor, i cili i nënshtrohet procedurës së arkivimit;
- zbaton me përpikmëri për aq sa i përket, të gjithë urdherat e miratuar nga titullari i gjykatës dalë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave “Për njehsimin e dokumenteve në Republikën e Shqipërisë”.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor. (kategoria IV-1)

1.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VECANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtete përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon; (IV-1)
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Specialist arkive:

- Të jetë diplomuar në drejtësi, shkencat shoqërore ose shkencat e komunikimit/gazetari ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës të paktën në nivelin ‘*Master Shkencor*’ ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë e së njëjtës fushë.
- të ketë përvojë profesionale jo më pak se 2(dy) vjet në fushën e arkivës
- të kenë njohuri të mira të përdorimit të programeve kompjuterike;
- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

1.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Lartë dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në link-un: <http://dap.gov.al/vende-vakante/duhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Kërkesë motivimi për pozicionin e shpallur vakant
- Fotokopje të diplomës “Master” (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të leternjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet
- Vërtetim nga gjykata
- Vërtetim nga prokuroria
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo me e-mail ne adresën: info@gjykataelarte.gov.al brenda datës **07.11.2024** ose në adresën: Gjykata e Lartë, Rruga “*Ibrahim Rrugova*”nr.20, Tiranë

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës **11.11.2024** Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë , www.gjykataelarte.gov.al dhe në faqen zyrtare të KLGJ, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional dhe intervista e strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës.

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind)

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve sipas kësaj procedure do ta gjeni në udhëzimin nr.85 , datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”

Intervistës me gojë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Specialist arkive:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”,(i ndryshuar)
- Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe Formatet “Model” 1 deri 12.
- Ligj nr. 119/2014 ” Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr.9131, Datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Vendim nr. 622, datë 10.12.2020 ” Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kuafikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al . të KLGJ www.klgj.al .

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës së Lartë duke filluar nga data 11.11.2024.

II.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATINË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon: **Specialist arkive:**

- Të jetë diplomuar në drejtësi, shkencat shoqërore ose shkencat e komunikimit/gazetari ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës të paktën në nivelin 'Master Shkencor' ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë. Edhe diploma Bachelor duhet të jetë e së njejtës fushë
- të ketë përvojë prej të paktën (1) një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale në gjykatë.

11.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë brenda datës **14.11.2024** dokumentacionin si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lnk-un:
- <http://dap.gov.al/vende-vakante/duhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formulant tip;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Vërtetim nga gjykata
- Vërtetim nga prokuroria

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

11.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **18.11.2024** do të shpallen në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë dhe KLGJ-së lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe **datën, vendin dhe orën** e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Specialist arkive:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar
- Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë (*Formatet “Model 1 deri në 12*)
- Ligj nr. 119/2014 ” Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr.9131, Datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Vendim nr. 622, datë 10.12.2020 ” *Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor*”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a – Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b – Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c – Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin e testimit me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, do të shpallet fituesi në faqen zyrtare të Gjykatësë Lartë dhe në faqen zyrtare të KLGJ-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**

- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës së Lartë, www.gjykataelarte.gov.al duke filluar nga data **18.11.2024**.

KËSHILLI I GJYKATËS

GJYKATA E LARTË

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë